ARBËN XHAFERI
Institute of Public Policy

Ndryshimet kushtetuese: çdoherë është koha për të bërë gjënë e duhur

Cilat janë amendamentet kushtetuese për zyrtarizimin e plotë të gjuhës shqipe?

Përmbajtja

Hyrje 3

Historiku i ndryshimeve kushtetuese në Maqedoninë e Veriut 5

Si ndryshohet Kushtetuta e Maqedonisë së Veriut? 5

Sa herë është ndryshuar Kushtetuta? 5

Si do duhej të duket zyrtarizimi i plotë i gjuhës shqipe në amendamentet kushtetuese të vitit 2023? 8

1. Amendamentimi i nenit 7 rreth regjimit të gjuhëve zyrtare 8

2. Amendament rreth autenticitetit dhe vlerës juridike të ligjeve 9

3. Amendament rreth autenticitetit dhe vlerës juridike të Kushtetutës 10

4. Amendamentimi i nenit 48 rreth gjuhëve të arsimimit 10

Konkluzion 12

Hyrje

"*Duhet ta përdorim kohën me mençuri dhe të kuptojmë përgjithmonë se çdoherë është koha për të bërë gjënë e duhur.*" Këto fjalë janë testament rreth nevojës së përhershme për ndryshim pozitiv që i ka lënë njerëzimit Nelson Mandela, padyshim një nga njerëzit më të mëdhenj që ka jetuar në planetin Tokë. Mandela, revolucionar, çlirimtar, politikan dhe filantrop, i cili shërbeu si President i Afrikës së Jugut nga 1994 deri në 1999, ishte artizani i zhbërjes së trashëgimisë së regjimit të aparteidit dhe i pajtimit racor në vendin e tij. A i la botës një trashëgimi politike të pashlyeshme, sipas së cilës nuk ka pushim karshi padrejtësisë dhe pabarazisë. Kjo trashëgimi tanimë kremtohet në baza vjetore nga OKB-ja në ditëlindjen e Mandelës, më 18 korrik, datë kjo e shpallur "Dita Ndërkombëtare e Nelson Mandelës".

Në Maqedoninë e Veriut, edhe pse asnjëherë nuk ka pasur aparteid kushtetues, në praktikë, përgjatë diktaturës komuniste dhe dekadës së parë së mëvetësisë, shteti ka zbatuar një politikë sistematike të shtypjes dhe segregracionit të shqiptarëve në jetën publike. Pa u kthyer në periudhën jugosllave, kujtojmë ngjarjet e Dibrës, Ladorishtit, Bit Pazarit, Gostivarit apo Aferën e Armëve, ku shqiptarë të pafajshëm u vranë, u torturuan dhe u burgosën, kryesisht në lidhje me kriza që e kishin burimin te Kushtetuta e vitit 1991, e miratuar në mënyrë unilaterale nga partitë politike maqedonase dhe e bazuar në minorizimin e shqiptarëve. Përveç shtypjes së egër, shqiptarët me rreth një të tretën e popullsisë së vendit, përfaqësoheshin në administratën publike me vetëm 3% të fuqisë punëtore përgjatë dekadës së parë të Maqedonisë së Veriut si shtet i pavarur. Kjo politikë segregacioniste prodhoi antagonizëm ndëretnik dhe pabesi të qytetarëve ndaj sistemit, që rezultuan në referendumin për autonomi territoriale dhe politike të vitit 1992 si dhe në kryengritjen e armatosur të vitit 2001.

Marrëveshja kornizë e Ohrit që i dha fundit konfliktit, ndërroi përgjithmonë natyrën e shtetit, tanimë i konceptuar si shtet multietnik dhe demokraci konsensuale, bazuar në tre parime themelore: votimi me shumicë të dyfishtë në çështjet jetike shtetërore; ndarja e pushtetit midis komuniteteve përmes parimit të përfaqësimit të drejtë dhe adekuat dhe; zyrtarizimi i gjuhës shqipe. Këto parime u futen në Kushtetutë në vitin 2001 dhe vetë Marrëveshja e Ohrit u bë pjesë e Preambulës së Kushtetutës në vitin 2019.

Megjithatë, mbi dy dekada pas Marrëveshjes së Ohrit, përveç votimit me shumicë të dyfishtë i njohur si mekanizmi i Badinterit, me emrin e konstitucionalistit francez Robert Badinter i cili kishte ndërmjetësuar në negociatat për Marrëveshjen e Ohrit, parimi i përfaqësimit adekuat dhe zyrtarizimi i gjuhës shqipe ngelin kryesisht të pazbatuara. Që të tria këto parime vazhdojnë të kontestohen në vazhdimësi nga partitë maqedonase. Ndërsa, mekanizmi i Badinterit është kategori kushtetuese nga e cila nuk mund të ketë devijim, përfaqësimi adekuat dhe zyrtarizimi i gjuhës shqipe kanë ngelur në nivel të parimeve, pa mekanizëm zbatues dhe me zgjidhje ligjore gjysmake siç janë mekanizmi i Balancerit apo ligji për përdorimin e gjuhëve, i cili

konfirmon statusin e gjuhës shqipe si gjuhë pjesërisht zyrtare dhe e përkthyer nga maqedonishtja.

Maqedonia e Veriut tani gjendet para një reforme të re kushtetuese si pasojë e propozimit francez që kushtëzon hapjen e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve historike dhe gjuhësore midis Sofjes dhe Shkupit, ndër tjera përmes futjes së bullgarëve në Kushtetutën e Maqedonisë së Veriut. Ndryshimet kushtetuese që duhet të ndodhin brenda këtij viti sipas agjendës evropiane, paraqesin një momentum të ri për zyrtarizimin e plotë të gjuhës shqipe si gjuhë bashkëzyrtare krahas asaj maqedonase, ndër tjera përmes heqjes së kompromisit nga viti 2001 që përcakton gjuhën shqipe si "*gjuha tjetër zyrtare që e flasin së paku 20% e qytetarëve*".

Por edhe pse të gjitha partitë kryesore në vend janë shprehur më herët se nuk janë kundër heqjes së 20 përqindëshit nga Kushtetuta, këto ditë, dy partitë kryesore të koalicionit qeverisës, LSDM përmes nënkryetares Sanja Llukarevska dhe BDI përmes ministrit të Jashtëm Bujar Osmani, kanë dalë publikisht kundër ose kanë shprehur rezerva rreth futjes së kësaj çështjeje në skicën e ndryshimeve kushtetuese, nën arsyetim se tani nuk është koha, se kjo çështje duhet të presë një moment tjetër më të përshtatshëm dhe se, kësaj radhe, fokusi duhet të jetë të ndryshimi i Preambulës dhe në rrugën evropiane të vendit.

Arsyetimet e tilla natyrisht se nuk mbajnë. Ato janë regresive, antihistorike dhe të sajuara për të kënaqur qarqet shoviniste maqedonase karshi një "kompromisi" të ri ndaj kërkesave legjitime të shqiptarëve. Se çdoherë është koha për të bërë gjënë e duhur siç do thoshte Mandela, e ka dëshmuar sondazhi i opinionit publik shqiptarë në Maqedoninë e Veriut i realizuar nga Instituti për Politika Publike Arbën Xhaferi: 90% e shqiptarëve besojnë se ndryshimet kushtetuese duhet të rezultojnë në një status të avancuar për gjuhën shqipe, e cila duhet të përkufizohet si gjuhë bashkëzyrtare, në të njëjtin nivel me maqedonishten.

Por si duket zyrtarizimi i plotë i gjuhës shqipe në Kushtetutën e Maqedonisë së Veriut?

Historiku i ndryshimeve kushtetuese në Maqedoninë e Veriut

Para se të diskutojmë përmbajtjen e duhur të ndryshimeve kushtetuese që po vijnë, është e nevojshme t'i kthehemi mënyrës dhe historikut të reformave kushtetuese nga pavarësia e vendit e këndej, për të kuptuar dinamikën dhe përmbajtjen e tyre.

Si ndryshohet Kushtetuta e Maqedonisë së Veriut?

Procedura për ndryshime kushtetuese përcaktohet me nenin 131 të Kushtetutës:

> ***Vendim për inicimin e ndryshimit të Kushtetutës e merr Kuvendi me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve.***
> ***Skicën për ndryshimin e Kushtetutës e përcakton Kuvendi me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve dhe e vë në diskutim publik.***
> ***Vendim për ndryshimin e Kushtetutës e merr Kuvendi me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve.***
> ***Ndryshimin e Kushtetutës e shpall Kuvendi.***
> ***Për vendimin mbi ndryshimin e Preambulës, neneve të vetadministrimit lokal, nenit 131, cilësdo dispozitë që ka të bëj me të drejtat e pjesëtarëve të bashkësive, përfshirë veçanërisht nenet 7, 8, 9, 19, 48, 56, 69, 77, 78, 86, 104 dhe 109, si dhe për vendimin për shtimin e çfarëdo dispozite të re, që ka të bëjë me përmbajtjen e atyre dispozitave dhe neneve, do të jetë e nevojshme shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve, me ç'rast medoemos duhet të ketë shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve të cilët u takojnë bashkësive të cilat nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.***

Nga kjo, është e qartë se nuk ka ndryshime kushtetuese pa pëlqimin e shumicës së deputetëve shqiptarë në Kuvendin e Maqedonisë së Veriut.

Sa herë është ndryshuar Kushtetuta?

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut e miratuar më 17 nëntor 1991, deri më tani është ndryshuar tetë herë dhe ka pësuar 36 amendamente: më 1992 (amendamentet 1 dhe 2), 1998 (amendamenti 3), 2001 (amendamentet 4-18), 2003 (amendamenti 19), 2005 (amendamentet 20-30), 2009 (amendamenti 31), 2011 (amendamenti 32) dhe 2019 (amendamentet 33-36).

- Amendamentet I dhe II të Kushtetutës u miratuan më 6 janar 1992 si pasojë e mosmarrëveshjeve me Greqinë, dhe ndryshuan nenet 3 dhe 49 që etablojnë

së Maqedonia e Veriut nuk ka pretendime territoriale ndaj shteteve fqinje dhe se ajo nuk përzihet në të drejtat sovrane të shteteve të tjera dhe në punët e tyre të brendshme.

- Amendamenti III u soll më 1 korrik 1998, për të ndryshuar nenin 12 rreth paraburgimit, dhe sjellë këtë procedurë në harmoni me përvojat ndërkombëtare që parashohin periudhë prej maksimum 180 ditë deri në aktakuzë.

- Amendamentet IV – XVIII u miratuan më 16 nëntor 2001, si obligim nga miratimi i Marrëveshjes së Ohrit duke transpozuar në Kushtetutë pjesën normative të saj, përfshirë futjen e 20 përqindëshit, përfaqësimit të drejtë, mekanizmit të Badinterit dhe një sërë rregullash rreth të drejtave dhe lirive të bashkësive, Avokatit të Popullit, krijimit të Komitetit për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive, vetadministrimit lokal, gjyqësorit dhe bashkësive fetare.

  Sa i përket përdorimit të gjuhëve, Amendamenti V ishte një kompromis i kohës që solli zgjidhje të improvizuar dhe *sui generis*, që nuk haset askundi në Evropë. Ky amendament përcakton se:

Në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në marrëdhëniet e saj ndërkombëtare, gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik.
Gjuhë tjetër që e flasin së paku 20% e qytetarëve, gjithashtu, është gjuhë zyrtare dhe alfabeti i saj, siç është përcaktuar me këtë nen.
Dokumentet personale të qytetarëve, të cilët flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase, lëshohen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj, si dhe në atë gjuhë dhe alfabetin e saj në përputhje me ligjin.
Cilido qytetar i cili jeton n ë njësitë e vetadministrimit lokal, në të cilën së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase, në komunikim me njësitë rajonale të ministrive, mund ta përdorë cilëndo nga gjuhët zyrtare dhe alfabetin e saj. Njësitë rajonale kompetente për ato njësi të vetadministrimit lokal, përgjigjen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën zyrtare dhe alfabetin të cilin e përdor qytetari. Çdo qytetar në komunikim me ministritë, mund ta përdorë njërën nga gjuhët zyrtare dhe alfabetin e saj, ndërsa ministritë përgjigjen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën zyrtare dhe alfabetin të cilin e përdor qytetari.
Në organet e pushtetit shtetëror në Republikën e Maqedonisë së Veriut, gjuha zyrtare e ndryshme nga gjuha maqedonase, mund të përdoret në përputhje me ligjin.
Në njësitë e vetadministrimit lokal gjuha dhe alfabeti që e përdorin së paku 20% e qytetarëve është gjuhë zyrtare, krahas gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj cirilik. Për përdorimin e gjuhëve dhe alfabeteve, në të cilat flasin së paku 20% e qytetarëve në njësitë e vetadministrimit lokal, vendosin organet e njësive të vetadministrimit lokal.

- Amendamenti XIX u e miratua më 26 dhjetor 2003 dhe rregullon lirinë dhe pacenueshmërinë e letrave, duke mundësuar një devijim në bazë të një vendimi të gjykatës, nën arsyetimin e mbrojtjes së interesave të sigurisë dhe mbrojtjes së vendit.

- Amendamentet XX – XXX u miratuan më 7 dhjetor 2005, si pasojë e reformës në drejtësi, dhe kishin të bënin veçanërisht me përzgjedhjen e gjyqtarëve dhe të prokurorëve, për të sjellë praktikën e vendit në përputhje me atë të Bashkimit Evropian.

- Më 9 janar 2009, u soll Amendamenti XXXI i Kushtetutës rreth mënyrës së zgjidhjes së presidentit (neni 81), duke ulur kushtin e pjesëmarrjes në zgjedhje në 40%, nga 50% sa ishte më parë pasi që ky kuorum nuk arrihej më dhe vendi përballej me krizë të mundshme kushtetuese.

- Amendamenti XXXII i 12 prillit 2011 erdhi si pasojë e obligimeve ndërkombëtare të Maqedonisë së Veriut në kuadër të Konventës Evropiane për Ekstradimin dhe ndryshoi nenin 4 të Kushtetutës, për të lejuar ekstradimin e shtetasve.

- Ndryshimet e fundit kushtetuese u miratuan më 11 janar 2019, si pasojë e Marrëveshjes së Prespës për zgjidhjen e kontestit me Greqinë. Amendamentet XXXIII – XXXVI ndërruan emrin kushtetues të vendit nga Maqedoni në Maqedoni e Veriut, intervenuan në Preambulë për të futur ndër tjera Marrëveshjen e Ohrit dhe riafirmuan parimin e respektimit të sovranitetit, integritetit territorial dhe të pavarësisë politike të shteteve fqinje.

Historiku i ndryshimeve kushtetuese dëshmon një gjë të pamohueshme: reformat kushtetuese asnjëherë nuk kanë ardhur si pasojë e dialogut të brendshëm ndërmjet bashkësive por ato kanë qenë çdoherë rezultat i obligimeve ndërkombëtare të vendit apo pasojë e krizave juridiko-kushtetuese.

Si do duhej të duket zyrtarizimi i plotë i gjuhës shqipe në amendamentet kushtetuese të vitit 2023?

Sipas propozimit francez dhe kornizës negociuese për anëtarësim në Bashkimin Evropian të korrikut 2022, është e qartë se amendament i paevitueshëm i Kushtetutës është futja e pakicës bullgare në Preambulë. Sipas regjistrimit të popullsisë së vitit 2021, në vend jetojnë 3.504 qytetarë me përkatësi bullgare. Pakicat tjera të cilat do të mund të pretendonin në futjen e tyre në Kushtetutë janë tërbeshët (4.174 qytetarë), egjiptianët (2.406 qytetarë), kroatët (2.145 qytetarë), malazezët (1.023 qytetarë). Është folur edhe për futjen e hebrenjve (66 qytetarë) në Kushtetutë. Gjithsej, sipas regjistrimit të fundit, janë evidentuar 49 etni apo kombësi të ndryshme si rezidente në territorin e vendit.

Çështjen e Preambulës lënë anash, nevojiten një sërë amendamente për t'u zyrtarizuar plotësisht gjuha shqipe, si gjuhë bashkëzyrtare në Maqedoninë e Veriut, gjë që shkon përtej diskutimit publik rreth heqjes së 20 përqindëshit, që është vetëm pjesa emocionale e problemit por assesi tërësia e tij. Më saktësisht, zyrtarizimi i plotë i gjuhës shqipe kërkon minimalisht 4 amandamente kushtetuese.

1. Amendamentimi i nenit 7 rreth regjimit të gjuhëve zyrtare

Neni 7 i paraqitur më sipër, rregullon regjimin e gjuhëve zyrtare në Maqedoninë e Veriut. Ky nen është rast *sui generis* në Evropë dhe madje ndoshta edhe në botë, dhe ai ka nevojë për thjeshtësim radikal për t'u sjellë në përputhje me përvojën kushtetuese të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, si dhe me rezultatet e regjistrimit të popullsisë së vitit 2021.

Sipas rezultateve të regjistrimit të popullsisë së vitit 2021, maqedonasit përbëjnë 57,86% të popullsisë totale të vendit, pasuar nga shqiptarët me 31,51%, turqit me 4,25%, romët me 2,50%, vllehët me 0,47%, serbët me 1,26%, boshnjakët me 0,92% dhe të tjerët me 1,23%. Marrë parasysh këto numra, është e qartë se përcaktimi i shprehur në përqindje për përdorimin e gjuhës shqipe në nivel shteti ka humbur arsyen e tij ligjore dhe nuk është në përputhje me karakteristikat sociodemografike të vendit.

Nuk haset në asnjë vend të Bashkimit Evropian një regjim i tillë gjuhësor, ku përcaktimi i një gjuhe zyrtare në nivel vendi shprehet në përqindje të folësve të saj krahasuar me popullatën e përgjithshme. Në nivelin lokal, megjithatë, ekzistojnë praktika të tilla kushtetuese por se zbatimi i tyre përcaktohet me ligj e jo me kushtetutë.

Poashtu, përcaktimi i një gjuhe zyrtare për marrëdhëniet ndërkombëtare të vendit është një aberracion që nuk haset në asnjë vend në Evropë, madje ndoshta as në botë, pasi që gjuha e marrëdhënieve ndërkombëtare të një vendi varet nga organizatat ndërkombëtare në të cilat është anëtar vendi. Kështu, për të marrë disa shembuj, Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB) ka gjashtë gjuhë zyrtare në të cilat shtetet komunikojnë mes vete dhe me trupat e ndryshme të OKB-së ; Bashkimi Evropian (BE-së) ka 24 gjuhë zyrtare ; NATO ka dy gjuhë zyrtare ; Këshilli i Evropës ka dy gjuhë zyrtare dhe Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë ka gjashtë gjuhë zyrtare. Në asnjërën nga këto organizata dhe në asnjë tjetër në të cilën Maqedonia e Veriut është anëtare, gjuha maqedonase nuk është zyrtare, andaj marrëdhëniet me këto organizata zhvillohen në një nga gjuhët e tyre zyrtare. Në raportet bilaterale me shtetet tjera, vlen po i njëjti konstatim: gjuha maqedonase nuk është zyrtare në asnjë shtet tjetër, duke e bërë përdorimin e saj zyrtar në komunikim me shtete të treta thjesht të pamundur.

Për fund, çështja e dokumenteve personale rregullohet gjithashtu me ligj në shtetet e Bashkimit Evropian dhe askundi me kushtetutë. Andaj, dispozita përkatëse nuk ka arsye të qëndrojë në Kushtetutën e vendit.

Bazuar në argumentet më sipër, propozim amendamenti për nenin 7 do duhej të duket si vijon:

> ***"Gjuhë zyrtare në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë gjuha maqedonase dhe gjuha shqipe, në shkrimin dhe alfabetin e tyre respektiv.***
> ***Në njësitë e vetadministrimit lokal në të cilat së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë të ndryshme nga gjuhët zyrtare, gjuha e tyre dhe alfabeti i saj do të jenë në përdorim zyrtar në nivel komune, në pajtim me ligjin.***
> ***Me këtë amendament zëvendësohet neni 7 i Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë."***

2. Amendament rreth autenticitetit dhe vlerës juridike të ligjeve

Nga barazia gjuhësore rrjedh problemi i autoritetit ligjor të gjuhëve zyrtare. Problemi i autenticitetit të versioneve gjuhësore të ligjeve lind vetvetiu në kontekstet shumëgjuhëshe kur ligjet duhet të zbatohen nga gjykatat, ngase fjalët nuk kanë vlerë të qenësishme: ato marrin kuptimin e tyre në një kontekst të caktuar në një kohë të caktuar. Për më tepër secila gjuhë ka specifikat e veta, që ndikojnë në zgjedhjen e fjalëve dhe rregullave gramatikore dhe sintaksore. Kjo është arsyeja pse nuk është e mundur të mbahet një korrespondencë e përsosur, si në formë ashtu edhe në kuptim, midis versioneve të ndryshme gjuhësore të një ligji.

Prandaj shtrohet çështja e versionit autentik të ligjeve. Në Bashkimin Evropian dhe në shtetet shumëgjuhëshe, çdo version gjuhësor i ligjeve të miratuara nga ligjvënësi konsiderohet njëlloj autentik për sa i përket interpretimit dhe kërkimit të qëllimit të ligjvënësit. Me fjalë tjera, çdo version gjuhësor konsiderohet si instrument ekuivalent për të përcjellë qëllimin e ligjvënësit dhe ato së bashku përbëjnë tekstin e ligjit.

Meqë gjuha maqedonase dhe gjuha shqipe janë bashkë zyrtare, autenticiteti dhe vlera juridike e ligjeve të miratuara dhe shpallura në dy gjuhët duhet të garantohen me Kushtetutë. Andaj, amendamenti rreth autenticitetit dhe vlerës juridike të versioneve gjuhësore të ligjeve do duhej të duket si vijon:

> ***"Ligjet miratohen dhe shpallen në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe, në shkrimin dhe alfabetin e tyre, dhe konsiderohen si origjinale dhe kanë të njëjtën vlerë juridike në të dyja gjuhët.***
> ***Me këtë amendament shtohet një nen 51/a pas nenit 51 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut."***

3. Amendament rreth autenticitetit dhe vlerës juridike të Kushtetutës

E njëjta çështje shtrohet edhe për autenticitetin dhe vlerën juridike të Kushtetutës. Meqë gjuha maqedonase dhe gjuha shqipe janë njëjtë zyrtare, autenticiteti dhe fuqia juridike e Kushtetutës duhet të garantohen në të dyja gjuhët. Amendamenti rreth kësaj çështje do duhej të duket si vijon:

> ***"Versionet në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe të kësaj Kushtetute, në shkrimin dhe alfabetin e tyre, konsiderohen si dy origjinale dhe kanë të njëjtën fuqi juridike.***
> ***Me këtë amendament shtohet një nen 133/a pas nenit 133 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut."***

4. Amendamentimi i nenit 48 rreth gjuhëve të arsimimit

Neni 48, paragrafi 4 i Kushtetutës përcakton se "*Pjesëtarët e bashkësive kanë të drejtë të ndjekin mësimin në gjuhën e tyre në arsimin fillor dhe të mesëm, në mënyrë të përcaktuar me ligj. Në shkollat në të cilat arsimimi zhvillohet në gjuhë tjetër, mësohet edhe gjuha maqedonase.*"

Fjalia e dytë e këtij paragrafi është problematike meqë ajo mohon karakterin zyrtar

të gjuhës shqipe, duke konsoliduar primatin e gjuhës maqedonase të etabluar nga Kushtetuta e vitit 1991. Andaj është e qartë se për t'u arritur barazia e plotë midis gjuhës shqipe dhe asaj maqedonase, edhe ky nen duhet të amendamentohet.

Rregullimi i gjuhëve të arsimimit megjithatë duhet të jetë çështje e dialogut midis partive politike, shoqërisë civile, shoqatave të prindërve dhe të nxënësve dhe palëve tjera të interesuara, me synim të arritjes së barazisë së plotë gjuhësore në arsim.

Dy zgjidhet e mundshme për të tejkaluar konfliktin e normave kushtetuese midis nenit 7 dhe nenit 48 të Kushtetutës janë: i) fshirja e fjalisë së dytë nga neni 48, paragrafi 4 që etablon obligimin për të mësuar gjuhën maqedonase në ato shkolla ku arsimimi zhvillohet në gjuhë tjetër ose; ii) futja e gjuhës shqipe në po këtë paragraf, në përputhje me frymën e nenit 7 të Kushtetutës rreth regjimit të gjuhëve zyrtare.

Konkluzion

Si përfundim, është e qartë se argumentet e llojit "tash nuk është koha" për zyrtarizimin e plotë gjuhës shqipe nuk mbajnë përderisa ndryshimet kushtetuese në Maqedoninë e Veriut asnjëherë nuk kanë ardhur si pasojë e dialogut të brendshëm ndërmjet bashkësive por ato kanë qenë çdoherë rezultat i obligimeve ndërkombëtare të vendit apo pasojë e krizave juridiko-kushtetuese.

Zyrtarizimi i plotë i gjuhës shqipe nuk është në shpërputhje me agjendën evropiane. Përkundrazi, diversiteti dhe shumëgjuhësia janë vlera evropiane. Madje, pikërisht me këtë logjikë, Bujar Osmani, në vitin 2017 si Zëvendës Kryeministër pëgjegjës për integrimin evropian, e kishte shtyrë përpara futjen e ligjit për përdorimin e gjuhëve në kuadër të strategjisë nacionale të legjislacionit për integrim në Bashkimin Evropian. Kjo kishte mundësuar që ligji të kalojë procedurën parlamentare me flamur evropian, si pjesë e agjendës evropiane. Andaj, rezervat e shprehura tani nga SDSM dhe BDI rreth 20 përqindëshit, përfshirë rezervat e Osmanit, nuk janë të sinqerta dhe nuk mbajnë pasi që bëhet fjalë për po të njëjtën çështje, vetëm se tani në rrafshin kushtetues.

Nga gjithë kjo, forcohet argumenti se tani më shumë se çdoherë është koha për zyrtarizimin e plotë të gjuhës shqipe, sepse një mundësi e tillë për të evropianizuar Maqedoninë e Veriut nuk do të vijë përsëri në të ardhmen e parashikueshme.

Shqiptarët që kanë qenë faktori kyç për ruajtjen e kursit pro-perëndimor të vendit, futjes së vendit në NATO dhe fitimit të vendimit të kushtëzuar për hapje të negociatave për anëtarësim në BE, nuk kanë asnjë arsye të tërhiqen nga kërkesat e tyre legjitime për status bashkëzyrtar të gjuhës shqipe, si pritshmëri pa ekuivoke e çdo shqiptari në vend.

Megjithatë, statusi bashkëzyrtar i gjuhës shqipe shkon përtej çështjes emocionale së 20 përqindëshit. Fokusimi në vetëm nenin 7 të Kushtetutës dhe 20 përqindëshin është gabim dhe heqja e 20 përqindëshit si masë e izoluar, nuk do zyrtarizonte gjuhën shqipe. Kjo do ishte një zgjidhje kozmetike dhe improvizim i radhës për konsum ditor, që kanë karakterizuar qasjen e BDI-së në vazhdimësi këto dy dekada.

Zyrtarimi i gjuhës shqipe si gjuhë bashkëzyrtare dhe në nivel të njëjtë me maqedonishten, kërkon reformë kushtetuese gjithëpërfshirëse, përmes së paku 4 amandamenteve kushtetuese, që rregullojnë regjimin e gjuhëve zyrtare, autenticitetin dhe vlerën juridike juridike të ligjeve dhe të Kushtetutës, si dhe gjuhët e arsimimit në nivel shteti.

Ndryshimet kushtetuese: çdoherë është koha për të bërë gjënë e duhur

Cilat janë amendamentet kushtetuese për zyrtarizimin e plotë të gjuhës shqipe?

Prill 2022

Instituti për Politika Publike Arbën Xhaferi
Rruga Dame Gruev 7/8/3
1000 Shkup
Maqedonia e Veriut

Tel: +389 2 522 2922
E-mail: info@ipp-arbenxhaferi.org
Web: www.ipp-arbenxhaferi.org